

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 424 Prot.

Tiranë, më 30.032017

VENDIM Nr. 40, datë 24.03.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 5 të datës 24.03.2017, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të Projektit "*Linja e Gazsjellësit TRANS ADRIATIK (TAP), Fushata e Tretë, KM 69 - KM 139,674*"-shoqëria "TAP AG", realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Lorenc Bejko,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të Projektit "*Linja e Gazsjellësit TRANS ADRIATIK (TAP), Fushata e Tretë, KM 69 - KM 139,674*"-shoqëria "TAP AG", realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Lorenc Bejko.
2. Për zonat me potencial të lartë arkeologjik, si Zona rreth Gradishtës së Peshtanit, Zona rreth Kalasë së Vojakës/Vojakut, Maja e Kodrës në fshatin Vojakë, Maja e Malit të Therpelit, Qafa/Pushimi i çobanit, KP 90+560 (CH-1106) dhe pikërisht:
 - Zona rreth Gradishtës së Peshtanit nga KP 134+500 deri në KP 133+500, ku në sipërfaqen e disa fushave të punuara janë parë sasi të konsiderueshme qeramike dhe strukturash në vendet e njohura si Bregu i Hamamit dhe Gorica e Dukës (CH – 1070; CH – 1071; CH – 1072; CH – 1073; CH – 1074),
 - Zona rreth Kalasë së Vojakës/Vojakut nga KP 129+500 deri në 129+085(CH – 1079; CH 1077 CH – 630),
 - Maja e Kodrës në fshatin Vojakë rreth KP 128+351 (CH – 378) ku janë janë identifikuar mbetje të varreve e dëmtuara,
 - Maja e Malit të Therpelit rreth KP 118+730 ku janë identifikuar rrënojat e një ndërtese nga e cila kishin mbetur disa gjurma dhe linja muresh (CH-1087),
 - Qafa/Pushimi i çobanit KP 95+500 (CH-1108) ku vëzhgimi arkeologjik ka gjetur shumë mbetje qeramike,

- **KP 90+560 (CH-1106)** ku vëzhgimi arkeologjik ka gjetur shumë mbetje qeramike, të kryhen sondazheve arkeologjike.
3. Për zonat e tjera që nuk janë konsideruar me potencial të lartë arkeologjik, Shoqëria "TAP AG" duhet të lidhë paraprkishtë akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për ndërtimin "Linja e Gazsjellësit TRANS ADRIATIK (TAP), Fushata e Tretë, KM 69 - KM 139,674, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
 4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
 5. Investitori duhet të realizojë pas ndërtimit të gazsjellësit, rikthimin e terrenit në gjendjen e tyre të mëparëshme, përsa i përket sistemeve tarracuese dhe sinoreve (pikat e ndarjeve të kullotave), në zonat e Skraparit dhe të zonave malore të Korçës.
 6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
 7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTER



SEKRETARI KKA
RUDINA ZOTO

